

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SHQIP” SH.P.K.



Ne mbeshtetje dhe zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "SHQIP" SH.P.K. (me poshte ne kete akt e quajtur "Shoqeria") nga Ortaku i Vetem:

1. Shoqeria anonime "Digit – Alb" Sh.a., perfaqesuar nga Z. Dritan HOXHA.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njeqindmije) leke.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 (njeqind) pjese me nje vlere nominale te barabarte me 1.000 (njemije) leke secila, te cilat zoterohen, 100% nga Ortaku i Vetem.

Objekt i veprimtarise do te jete:

- Botimi, prodhimi dhe shperndarja e revistave, gazetave, librave, disqeve dhe materialeve te tjera te lejuara me ligj;
- Organizimi i te gjitha aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe lojrave te ndryshme te lejuara me ligj;
- Kryerja e aktivitetit te marketingut, te agjentit komisioner apo te perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja;
- Konsulence ne fushen mediatike, publicistike, ekonomike dhe financiare;
- Cdo veprimtari tjeter te lejuar me ligj, qe kane lidhje direkte apo indirekte me objektin social si edhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me te.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar. Kjo periudhe mund te ndryshoje paraprakisht me vendim te Asamblese se Ortakeve ose per shkaqe te tjera te parashikuara nga ligji.

Selia administrative e shoqerise do te jete ne Tirane, Bulevardi "Zogu I", Pallati 13 katesh, perballe Stacionit te trenit.

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator, detyren e te cilit do ta kryeje per peruidhen e pare prej tre vjetesh, Z. Dritan Hoxha i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me


perjashtim te kompetencave qe ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblese se Ortakeve dhe per ceshnje te rendesishme konsultohet apo merr miratim sipas rastit nga Ortaket.

THEMELUESI:

“Digit – Alb” Sh.a.

Perfaqesues i Ortakut te Vetem

DRITAN HOXHA

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Dritan Hoxha', is written over the printed name. The signature is stylized and somewhat cursive.

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SHQIP” SH.P.K.

Ortaku i vetem i shoqerise “SHQIP” SH.P.K. eshte:

1. Shoqeria anonime “Digit – Alb” Sh.a., perfaqesuar nga Z. Dritan HOXHA, qe ketu me poshte do te quhet “Ortaku i Vetem”;

Dhe qe deklararon se miraton kete statut me dispozitat e meposhtme:

KAPITULLI I Legjislacioni, Forma

Neni 1

Shoqeria “SHQIP” Sh.p.k., qe ne vazhdim shkurtimisht do te quhet “shoqeria” eshte krijuar ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 “Per Shoqerite Tregtare” dhe te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

Neni 2

Forma juridike e shoqerise eshte ajo e “shoqerise me pergjegjesi te kufizuar” prandaj pergjegjesia e ortakeve eshte e kufizuar deri ne shumen e pjeses se zoteruar nga kapitali themeltar.

Shoqeria, pavarsisht nga objekti i veprimtarise, quhet tregtare dhe i nenshtrohet rregullave te percaktuara ne Kodin Tregtar te Republikes se Shqiperise.

KAPITULLI II Emertimi, Selia, Kohezgjatja

Neni 3

Emertimi i shoqerise eshte:

“SHQIP” SH.P.K.



Neni 4

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane, Bulevardi "Zogu I", Pallati 13 katesh, perballe Stacionit te trenit. Ne baze te ligjit shoqeria mund te hape apo krijoje seli dytesore dhe administrative, dege, filiale, agjenci, zyra perfaqesie si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj.

Neni 5

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pacaktuar. Kjo periudhe mund te zgjatet apo te nderpritet paraprakisht me vendim te Asamblese se Ortakeve ose per shkaqe te tjera te parashikuara nga ligji.

KAPITULLI III Objekti

Neni 6

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Botimi, prodhimi dhe shpermdarja e revistave, gazetave, librave, disqeve dhe materialeve te tjera te lejuara me ligj;
- Organizimi i te gjitha aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe lojrave te ndryshme te lejuara me ligj;
- Kryerja e aktivitetit te marketingut, te agjentit komisioner apo te perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja;
- Konsulence ne fushen mediatike, publicistike, ekonomike dhe financiare;
- Cdo veprimtari tjetër te lejuar me ligj, qe kane lidhje direkte apo indirekte me objektin social si edhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me te.

KAPITULLI IV Kapitali Themeltar

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100,000.00 (njqindmije) Leke.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 (njqind) pjese me nje vlere nominale te barabarte me 1.000 (njemije) leke secila, te cilat zoterohen, 100% nga Ortaku i Vetem.

Neni 8

Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te Ortakut te Vetem. Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me derdhje ne para ose me kontribute



ne natyre, ne kete rast keto kontribute duhet te shoqerohen me nje raport vleresimi tekniko-financiar te kryer nga nje ekspert i vleresimit te kontributeve, te emeruar nga Ortaku i Vetem dhe qe duhet t'i bashkelidhet vendimit te Ortakut te Vetem.

Neni 9
Zvogelimi i kapitalit

Zvogelimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te Ortakut te Vetem, me propozim te administratorit, vetem ne rastin kur shoqeria mund te pesoje humbje te tilla qe e bejne te domosdoshem kete zvogelim.

Kapitali themeltar nuk mund te jete me i vogel se vlera minimale e caktuar me ligj, ne rast te kundert shoqeria detyrohet te ndryshoje formen juridike ose te priset.

Neni 10
Transferimi i pjeseve te kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie per shkak vdekje. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin paraprak te Ortakut te Vetem sipas dispozitave ligjore per kete qellim.

KAPITULLI V Ortaket e Shoqerise

Neni 11
Ortaku i Vetem

Ortaku i Vetem i shoqerise luan rolin dhe ka kompetencat qe ligji "Per shoqerite tregtare" ia njeh Asamblese se ortakeve ne shoqerite e kesaj forme te themeluara nga disa ortake.

Vendimet e Ortakut te Vetem shenohen ne nje regjister qe mbahet ne seline e shoqerise.

Ortaku i Vetem brenda tre muajve nga dita e mbylljes se vitit financiar miraton raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar, te hartuara dhe paraqitura nga administratori.

Neni 12

Asambleja e zakonshme apo e jashtezakonshme mund te mbahet qofte ne ambjentet e selise se shoqerise apo ne vende te tjera duke njoftuar ortakun me leter rekomande te paktën 15 dite perpara mbledhjes se asamblese. Ne kete leter njoftohet rendi i dites dhe gjithashtu mund te perfshihet edhe data e mbledhjes se dyte ne rast se e para anulohet.



Lajmërimi bëhet nga administratori ose, në mungesë të tij, nga eksperti kontabël i autorizuar, po qe se ka të tillë. Cdo mbledhje e asamblesë e thirrur në mënyrë të parregullt, mund të anulohet. Megjithatë anulimi nuk ka vlerë, në rast se Ortaku i Vetem është i pranishëm. Asambleja e zakonshme duhet të mbledhet te pakten njëherë ne vit, brenda 4 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 13

Ne mbledhjen e asamblese mund të marrin pjese te gjithë personat qe rezultojne te regjistruar ne librin e ortakeve deri ne daten e mbledhjes. Secili prej ortakeve ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet edhe nga nje person i trete jo ortak i pajisur me prokure.

Neni 14

Ne mbledhjet e asamblese se zakonshme dhe te jashtezakonshme vendimet merren me vendim te Ortakut te Vetem. Vendimet e asamblese duhet te pasqyrohen nga proceverbalet e nenshkruara nga Administratori dhe Sekretari apo nga Noteri.

KAPITULLI VI Administrimi i shoqerise

Neni 15

Emerimi i administratorit


Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i cili mund te zgjidhet brenda ose jashte bashkesise se ortakeve.

Emerimi i administratorit behet me vendim te Ortakut te Vetem. Ai zgjidhet per nje periudhe tre vjecare dhe eshte i rizgjedhshem.
Administrator i shoqerise do te jete Z. Dritan HOXHA.

Veprimtaria e perditshme e shoqerise drejtohet nga administratoret, te cilet per realizimin e qellimeve te shoqerise kane te drejte t'a perfaqesojë ate dhe ne emer te saj te paraqitet para te gjitha organeve e institucioneve shteterore apo private, te lidhe kontrata si dhe te paraqitet perpara gjykatave te te gjitha shkalleve per mbrojtjen e interesave te shoqerise. Administratori mund te lidhe kontrata pa miratimin e Ortakut te Vetem deri ne masen _____ Leke / USD.

Gjithashtu administratori ka te drejte qe me prokure te posacme te autorizojë dhe jape tagrat e nevojshme personave te ndryshem te specializuar ne fusha te ndryshme, gjithmone per mbrojtjen e interesave te shoqerise.

Asambleja ka te drejte te ndryshojë numrin e Administratoreve te shoqerise ne cdo moment qe ajo e konsideron te nevojshem.



Ne cdo rast Administratori shkarkohet vetem me vendimin unanimit te ortakeve. Cdo klauzole e kundert konsiderohet e pavlefshme. Ne rast shkarkimi pa nje arsye te drejte lihet shkak per demshperblim financiar.

Neni 16

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit ose per faje te kryera dhe deme te shkaktuara gjate administrimit te tij.

Neni 17

Administratorit mund t'i atribuohen shperblime dhe/ose paga te percaktuara nga Asambleja e Ortakeve. Administratori eshte i ngarkuar me rimbursimin e shpenzimeve te kryera per arsye te detyres se tyre, te cilat nuk mbulohen drejtperdrejt nga shoqeria.

KAPITULLI VII Te ndryshme

Neni 18

Miratimi i llogarive

Administratori brenda tre muajve nga dita e mbylljes se vitit financiar harton dhe i paraqet Asamblese se Ortakeve per miratim, raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore.

Ortaket kane te drejte te marrin ne cdo kohe dhe kontrolloje dokumentat e mesiperme, per tre vitet e fundit financiare, si dhe mund te ndihmohen nga nje ekspert i zgjedhur prej tyre, i cili i nenshtrohet detyrimit per te ruajtur sekretin profesional.

Neni 19

Veprimtaria dhe viti fiskal i shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti.

Neni 20

Nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur te gjitha shpenzimet dhe po te jete nevoja edhe humbjet e vitit te meparshem, lihet menjane nje shume me vlere jo me pak se 5% e fitimit, e cila nevojitet per formimin e fondit rezerve qe quhet "rezerva e domosdoshme", derisa kjo rezerve te arrije te pakten sa 1/10 e kapitalit themeltar.

Pjesa tjeter e fitimit perdoret sipas vendimit te Ortakut te Vetem.

Neni 21



Te gjithë dokumentet e shoqërisë, përfshirë vendimet e Administratoreve dhe ato të Asamblese së Ortakëve duhet të hartohen në gjuhën shqipe.

Neni 22

Ortakët në çdo kohë mund të vendosin prishjen e shoqërisë, në vartësi të gjendjes ekonomiko-financiare apo edhe shkaqeve të tjera që atyre mund t'u duken të arsyeshme, prishje e cila detyrimisht sjell një likuidim që do të bëhet sipas procedurave ligjore për likuidimin, të përcaktuara në ligjin "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 23

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë statut referimi do të bëhet në dispozitat ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie juridike.

Për konfliktet të cilat nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, palët kanë të drejtë të drejtohen në gjykatën kompetente.

Statuti hartohet në 4 ekzemplare origjinale në gjuhën Shqipe, një prej të cilëve mbahen nga Ortaku i Vetëm dhe tjetri nga Noteri e institucionet përkatëse.

ORTAKU I VETËM

"Digit – Alb" Sh.a.

Perfaqësues i Ortakut të Vetëm

DRITAN HOXHA

Dritan Hoxha